

**BASHKIA PEQIN**  
**NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA**

Për dhënien me qira nëpërmjet procedurës së konkurrimit publik të ekonomisë pyjore “Zalli Shkumbin”, fshati Përparim, Nj.A Përparim, në pronësi të Bashkisë Peqin, të ngastrës pyjore me Nr.pasurie 5/1, ZK. 2921, lloji “Pyll”, me sipërfaqe 7.7 ha, për agropylltari.

1. Autoriteti qiradhënës: Bashkia Peqin, (NJ.Q.V.)

Adresa: *Bulevardi “Mustafa Gjinishi”, Peqin, Nr.tel.: 00355698754123, e-mail: info@peqini.gov.al.*

Njofton;

2. Të dhëna për sipërfaqen dhe aktivitetin: Fillimin e procedurave për dhënien me qira, me konkurrim publik të sipërfaqes të fondit kullor me objekt “Dhënien me qira të ekonomisë pyjore “\_\_\_”, fshati Përparim, Njësia Administrative Përparim, në pronësi të Bashkisë Peqin, me sipërfaqe 7.7 ha, ngastra me Nr.pasurie 5/1, zona kadastrale 2921, vol. 4, faqe 220, lloji “Pyll”

Dhënie me qira e pasurisë së paluajtshme behet në zbatim të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime ne Vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr.1, date 09.06.2016 ”Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” (në vazhdim “Legjislacioni në fuqi për fondin pyjor dhe kullor publik”) dhe të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Peqin Nr.24, datë 21.04.2020 “Për miratimin e listës së sipërfaqeve të fondit pyjor/kullor që do të jepen me qira”

3. Qëllimi i përdorimit/dhënies me qira: Pasuria shtetërore jepet me qira me qëllim agropylltari.

4. Vlera dysheme për detyrimin e qirasë, për fillimin e konkurrimit publik, është 77 000 (shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë/vit.

5. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie është 10 (dhjetë) vjet.

Pikët vlerësuese do të jenë :

Nr.	Lloji i Kriterit	Pesha e matur në pike e kriterit vlerësues(e shprehur në pikë)
1	Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit	20
2	Planbiznesi dhe investimet që do të bëhen	15
3	Planin e rehabilitimit të sipërfaqes	15
4	Nivelin e punësimit në veprimtari	5

5	Masën e qirasë për ha/vit	35
---	---------------------------	----

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë :

- a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.(vertetim te gjendjes gjyqësore, vertetim nga prokuroia, gjykata, drejtoria rajonale tatimore etj.)

Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohej oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurimit të parashikuar sipas planit të biznesit;
2. Ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
3. Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
4. Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
5. të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
6. planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
7. nivelin e punësimit në veprimtari;
8. lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar;
9. çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
10. adresën e subjektit, telefon, *email* dhe faks;

Dokumentacion duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për dhënie me qira“, dhe i dorëzohen komisionit të posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit, në orën e hapjes së procedurës së konkurimit.

Mos paraqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme përbën kusht skualifikues. Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurimit.

Data e zhvillimit të konkurimit : 18.06.2020, ora 12.00

Vendi i zhvillimit të procedurës së konkurimit: Bashkia Peqin, Kati i Dytë, Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjeve.

Dokumentacioni i nevojshëm për subjektet e interesuar mund të tërhiqet: pranë Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjeve, në godinën e Bashkisë Peqin, nga e nesërmja e shpalljes së Njoftimit në Agjensinë e Prokurimit Publik, nga data 08.06.2020.

Dokumente me pagesë: Po                      Monedha 500 (pesëqind) lekë.

Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 18.06.2020 ora 12.00.